


NGA FRIKA NË DËSHMI - TEMË SHPIRTËRORE E MBAJTUR ME TË RINJTË ORTHODHOKSË TË TIRANËS ME TEOLOGUN Z. DHIMITËR QOSJA, MAJ 2026



Tema që do të ndajmë sot së bashku lidhet me përvojën e apostujve të Krishtit: kalimin e tyre nga frika në dëshmi, transformimin e tyre të thellë shpirtëror dhe ekzistencial. Apostujt jetuan pranë Krishtit, dëgjuan mësimet e Tij, panë mrekullitë e Tij dhe morën premtimet që Ai u dha. Megjithatë, kur erdhi çasti i Pësimeve dhe Kryqëzimit, ata u shpërndanë, u fshehën dhe u pushtuan nga frika. Më vonë, po këta njerëz u shndërruan në dëshmitarë të guximshëm të Ngjalljes, siç e shohim qartë në Veprat e Apostujve.

Ne ndodhemi në periudhën e bekuar të Ngjalljes, një kohë që nuk na thërret thjesht të kujtojmë një ngjarje historike, por ta jetojmë dhe ta përjetojmë atë. Të krishterët nuk i kremtojnë festat vetëm si kujtime simbolike, por si realitete të gjalla që kërkojnë pjesëmarrjen tonë personale. Kisha, përmes ciklit të saj liturgjik, na mëson vazhdimisht të hyjmë në thelbin e këtyre ngjarjeve dhe të reflektojmë mbi mënyrën se si ato transformojnë jetën tonë.

Përpara gëzimit të Ngjalljes vjen Java e Madhe, java e Pësimeve të Krishtit. Krishti ua kishte paralajmëruar apostujve gjithçka që do të ndodhte. Ai u foli hapur për vuajtjet e Tij dhe i përgatiti për atë që po afrohej. Megjithatë, dobësia njerëzore u shfaq qartë. Apostulli Pjetri deklaroi me vendosmëri se ishte gati të jepte jetën për Krishtin, por pak më vonë e mohoi tri herë. Të tjerët gjithashtu u larguan dhe u fshehën “nga frika e judenjve”.

Pyetja që lind natyrshëm është: çfarë ndodhi me këta nxënës të Krishtit? Si është e mundur që ata, të cilët kishin parë mrekulli dhe kishin jetuar pranë Tij, kaluan nga entuziazmi dhe besnikëria në dëshpërim dhe izolim? Çfarë i frikësoi kaq shumë? A u tronditën nga pësimet e Krishtit? A u zhgënjyen nga pritshmëritë që kishin për Të? Ungjilli na tregon se ata u mbyllën “me dyert të kyçura”. Frika i izoloj dhe i paralizoi. Por menjëherë pas Ngjalljes ndodh një ndryshim rrënjësor: ata që ishin të trembur dhe të mbyllur bëhen njerëz të guximshëm, të gatshëm të predikojnë publikisht dhe të sakrifikojnë jetën e tyre për Krishtin.

Ky transformim nuk mund të shpjegohet thjesht psikologjikisht apo emocionalisht. Ai është shumë më i thellë. Apostujt nuk përjetuan vetëm një ndryshim humori apo gjendjeje shpirtërore. Ata takuan Krishtin e Ngjallur. Pikërisht ky takim ndryshoi gjithçka.



Ngjallja e Krishtit nuk është thjesht një mrekulli ndër shumë të tjera; ajo është themeli i besimit të krishterë. Krishti, me vdekjen e Tij, e mundi vdekjen. Kjo është arsyeja pse Pashka përbën qendrën e jetës sonë të krishterë. Apostujt nuk dolën për të përhapur një ideologji apo një filozofi morale. Ata dëshmuan një përvojë reale: takimin me Zotin e Ngjallur.

Edhe ne sot nuk jemi të thirrur të mbrojmë thjesht një sistem idesh apo një traditë kulturore. Jemi të thirrur të hyjmë në një marrëdhënie personale me Krishtin e Ngjallur. Besimi i krishterë nuk kufizohet në slogane morale apo në disa parime abstrakte mbi paqen dhe mirësinë; ai buron nga përvoja e gjallë e Kishës dhe nga takimi real me Zotin.

Frika më e madhe e njeriut është vdekja. Vetëm ai që çlirohet nga frika e vdekjes mund të jetë vërtet i lirë. Apostujt nuk e humbën plotësisht ndjenjën e frikës, por e transformuan atë në guxim, dashuri dhe ofrim. Ky transformim ndodhi përmes përvojës së tyre me Krishtin e Ngjallur dhe përmes fuqisë së Shpirtit të Shenjtë.

Veprat e Apostujve na tregojnë se zbritja e Shpirtit të Shenjtë i ndryshoi rrënjësisht jetët e tyre. Shpirti i Shenjtë është Ai që i jep jetë Kishës, që krijon bashkësi dhe që transformon zemrën e njeriut. Apostujt kaluan nga izolimi dhe dëshpërimi në një jetë plot paqe, guxim dhe dëshmi publike.

Edhe ne sot përballemi me frikëra të shumta. Ndoshta nuk kemi frikë nga martirizimi fizik, si apostujt, por përjetojmë frikëra të tjera më të fshehta dhe më dinake: frikën e refuzimit, të vetmisë, të pasigurisë, të dështimit, të humbjes së pranimit shoqëror. Shoqëria moderne prodhon shpesh izolim dhe pasiguri shpirtërore.

Një nga krizat më të mëdha të kohës sonë është kriza e kuptimit të jetës. Jetojmë në një epokë me shumë informacion dhe zhvillim teknologjik, por pa një orientim të qartë shpirtëror. Njeriu pyet veten: pse ekzistojmë, ku po shkojmë, cili është kuptimi i jetës dhe i vdekjes?

Një tjetër sfidë është individualizmi. Gjithnjë e më shumë njeriu mbyllet në egoizëm dhe krenari, duke humbur kuptimin e komunitetit dhe të bashkësisë. Po ashtu përballemi me relativizmin, me idenë se nuk ekziston e vërteta absolute dhe se gjithçka është subjektive. Por për të krishterët, e vërteta nuk është një teori; e vërteta është Personi i Krishtit të Ngjallur.

Shumë njerëz sot lodhen shpirtërisht, jo sepse mohojnë ekzistencën e Zotit, por sepse nuk arrijnë të ndërtojnë një marrëdhënie reale me Të. Nuk mjafton të thuash "besoj në Zot"; pyetja thelbësore është: si jeton me Të? Si e ndërton këtë marrëdhënie dashurie dhe besimi?

Përgjigjen e gjejmë sërish te apostujt. Ata gjenin forcë kur mblidheshin së bashku, në thyerjen e bukës dhe në ndarjen e kupës, pra në Eukaristi. Aty takonin Krishtin e Ngjallur dhe forcoheshin në bashkësi.

Në një kohë kur shumë marrëdhënie mbeten virtuale dhe sipërfaqësore, Kisha na thërret në bashkim real me Zotin dhe me njëri-tjetrin. Vetëm përmes kësaj jete komunitare mund të kapërcejmë izolimin dhe vetminë shpirtërore.

Apostujt jetuan gjithashtu frymën e solidaritetit. Ata ndanin jo vetëm fjalën e Zotit, por edhe të mirat materiale me ata që kishin nevojë. Kjo frymë dashurie dhe kujdesi reciprok ishte pjesë e dëshmisë së tyre.

Bota nuk ndryshohet nga njerëzit që nuk kanë frikë, por nga ata që, edhe pse kanë frikë, mbështeten te Krishti i Ngjallur. Apostujt nuk ishin njerëz të përsosur. Ata ishin të dobët, të pasigurt dhe me shumë mangësi. Megjithatë, nuk pritën të bëheshin të përsosur për të dëshmuar. Pikërisht në dobësinë e tyre u shfaq fuqia e Zotit.

Edhe ne shpesh presim të jemi më të fortë, më të përgatitur apo më të sigurt për të jetuar dhe dëshmuar besimin tonë. Por përvoja e apostujve na mëson se transformimi i vërtetë nuk vjen nga forca njerëzore, por nga marrëdhënia reale me Zotin.

Sa më shumë ta jetojmë këtë marrëdhënie, aq më shumë transformohemi. Ky transformim nuk ndodh menjëherë; ai është një proces i vazhdueshëm, një rrugë e tërë jete. Një rrugë ku njeriu përballlet me frikërat dhe dobësitë e veta, duke ia

dorëzuar ato Zotit që t'i shndërrojë në forcë dhe dëshmi.

Kjo është thirrja jonë sot: të mos mbetemi të mbyllur në frikë dhe pasiguri, por të hapemi ndaj Krishtit të Ngjallur dhe ta jetojmë besimin tonë konkretisht. Bota ka nevojë për njerëz që nuk flasin vetëm për besimin, por e jetojnë atë.

Dhe kjo fillon nga secili prej nesh: nga mënyra se si lidhemi me Zotin, si jetojmë në bashkësi me njëri-tjetrin dhe si e dëshmojmë dashurinë dhe shpresën në jetën e përditshme.

Kjo është rruga që na tregojnë apostujt.

Kjo është rruga që na tregon Kisha.

Dhe kjo është rruga që jemi të thirrur të ndjekim edhe ne sot: kalimi nga frika në dëshmi.

media.ngjallja.org